



*Republika e Shqipërisë
Kryeministri*

Tiranë, më 22 prill 2016

I nderuar zoti Noka,

Sic besoj se jeni në dijeni, edhe për shkak të detyrës që Ju keni mbajtur gjatë mandatit të qeverisë së mëparshme, vendi ynë ka pasur një angazhim të kahershëm për të gjetur një zgjidhje për çështjen MEK.

Duke pasur parasysh kushtet ekstreme dhe situatën e tensionuar që rrezikonte jetën e një komuniteti shtetasish iranianë, anëtarë të organizatës MEK që jetonin në Irak, Qeveria shqiptare e gjykoi të udhës të vendosej në krah të aleatit tonë strategjik, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për të ndihmuar në evakuimin urgjent të këtij komuniteti nga Iraku, përkohësisht drejt Shqipërisë.

Nga viti 2013 e deri më sot, numri i personave të ardhur në Shqipëri është 1001, ndërkohë që sipas pritshmërive tona do të jenë edhe 1900 persona të tjera që do të mbërrijnë brenda vitit 2016. Ata kanë ardhur në grupe të vogla, të përbërë nga 20 deri në 120 vetë dhe aktualisht janë strehuar në banesa kolektive në periferi të Tiranës. Të gjithë këta persona, pjesë e organizatës MEK, vetëfinancohen, ndërsa autoritetet shqiptare janë në bashkëpunim të ngushtë me organizata të ndryshme ndërkombëtare si UNHCR, IOM apo RMSA.

Në momentin që këta qytetarë hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, autoritetet informojnë Shërbimin Informativ Shtetëror dhe Policinë e Shtetit. Këto institucione informohen edhe për çdo lëvizje tjeter të anëtarëve të MEK, apo për ndryshime të mundshme të adresës së qëndrimit në Shqipëri.


Deri më sot, vetëm një prej këtyre qytetarëve është larguar drejt Francës, sigurisht i regjistruar në sistemin TIMS, i pajisur me leje kalimi. Ministria e Punëve të Brendshme nuk ka lëshuar asnë dokument udhëtimi për këta qytetarë. Ndërkohë, çdo anëtar i organizatës MEK i ardhur në Shqipëri është pajisur me leje qëndrimi, si edhe kartë shëndetësore.

Secili prej personave të mbërritur deri më tani në vendin tonë është marrë mbi baza humanitare dhe do të trajtohet sipas kuadrit ligor në fuqi. Deri më sot,asnë prej qytetarëve anëtarë të MEK nuk ka aplikuar për nënshtetësi shqiptare.

Dëshiroj t'Ju informoj se Qeveria shqiptare ka marrë të gjitha masat e nevojshme, në bashkëpunim të ngushtë edhe me partnerët tanë të huaj, për të qenë në lartësinë e duhur në këtë operacion humanitar të rëndësishëm. Vlen të theksohet se deri më sot, 1001 qytetarët e ardhur në vendin tonë janë integruar më së miri në komunitet, duke mos shënuar asnë hjo incidenti serioz. Ata kanë mësuar gjuhën shqipe dhe disa prej tyre kanë filluar punë.

Duke Ju falënderuar për interesimin Tuaj,

Edi Rama

A handwritten signature in black ink, appearing to read "Edi Rama". It consists of a stylized 'E' at the top, followed by a vertical 'd', a horizontal 'i', and a long, sweeping 'a' at the bottom right.

Z. Flamur Noka
Zëvendëskrytar i Komisionit të Sigurisë Kombëtare
Kuvendi i Shqipërisë
Tiranë